



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

PROGRAMI I LËNDËS BIO 378

LËNDA:	Etologji
Titullari/ Pedagogu i lëndës:	PhD. Ina Nasto
Ngarkesa:	2 lex / 1 sem
Tipologjia e lëndës:	Të formimit karakterizues të programit
Viti akademik/ semestri kur zhvillohet:	Pranverë 2019
Lloji i lëndës:	E Detyrueshme
Programi i studimit:	Bachelor
Kredite:	4 Kredite
Kodi i lëndës:	BIO 378
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut:	ina.nasto@yahoo.com

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Etologjia është shkencë që studjon mekanizmat e sjelljes së botës shtazore. Objektivat e këtij kursi janë të përshkruaj disa nga mekanizmat kryesorë të botës shtazore, të tregojë mënyrat e shfaqjes së tyre, klasifikimin dhe krahasimin e tyre me sjelljet analoge në shoqërinë njerëzore. Gjatë zhvillimit të lëndës së Etologjisë studenti duhet të njihet me konceptet bazë të lëndës, dhe të aftësohet në njohjen e disa tipesh sjellje, gjithashtu dhe të kërkojë këto tipe sjelljesh në kafshë të ndryshme sipas përshkrimit të tyre në literatura të ndryshme.

KONCEPTET THEMELORE:

- 1 Koncepti i sjelljes dhe mekanizmat e saj
- 2 Klasifikimi i sjelljes
- 3 Modelet e sjelljes për lloje të ndryshme, dhe si shfaqet ajo.
- 4 Teoria e të mesuarit dhe evolucioni i saj.

TEMAT E LËNDËS:

Temat që do trajtohen në leksione:

- Tema 1** Hyrje në etologji. Etologjia si shkencë. Historia e studimeve etologjike.
- Tema 2** Interpretimi i sjelljes. Interpretimi i sjelljes. Organizimi i sjelljes. Organizimi social. Tipet e sjelljes.
- Tema 3** Kafshët dhe bota e jashtme. Stimujt. Energjia e pragut. Gjendja e konfliktit dhe zgjidhja e saj. Baza gjenetike e sjelljes.
- Tema 4** Faktorët gjenetikë përcaktues të sjelljes. Gjenet e sjelljes. Veprimi i përzgjedhjes natyrore mbi sjelljen.
- Tema 5** Teoria e epigjenezës. Baza fiziologjike e sjelljes. Qelizat nervore. Zhvillimi i snq në botën shtazore.
- Tema 6** Rregullimi hormonal i sjelljes. Ndjeshmëria dhe perceptimi tek organizmat.
- Tema 7** Orientimi me anë të shqisave të tjera. Orientimi i organizmave migratore.
- Tema 8** Sjellja riprodhuese. Strategjia konkurruese e meshkujve.
- Tema 9** Strategjia perzgjedhëse e femrave. Ritualet martesore. Gabimet në sjelljen riprodhuese.
- Tema 10** Sjellja prindërore. Sjelljet prindërore ndaj të vegjëlve të tjerëve. Demtimi apo vrasja e të vegjëlve.

- Tema 11** Inteligjenca dhe përdorimi i mjeteve të punës. Aspekte krahasuese të inteligjencës dhe trurit.
- Tema 12** Studimi i inteligjencës. Të kuptuarit dhe të menduarit tek kafshët.
- Tema 13** Mekanizmat e vendimmarrjes tek kafshët. Konkurenca motivuese. Optimizimi në vendimmarrje.
- Tema 14** Çështje të organizmit dhe sjelljes së primatëve. Evolucioni i primatëve. Strategjitë e evolucionit të jetës tek primatët
- Tema 15** Ciftezhimi tek primatët. Struktura sociale.

Temat që do trajtohen në seminare:

- Tema 1** Hyrje në etologji. Interpretimi i sjelljes. Organizimi i sjelljes. Organizimi social
- Tema 2** Tipet e sjelljes
- Tema 3** Baza gjenetike e sjelljes
- Tema 4** Teoria e epigjenezes. Ndikimi i mjedisit dhe modifikimet e shprehjes së gjeneve
- Tema 5** Baza fiziologjike e sjelljes
- Tema 6** Ndjeshmeria dhe perceptimi tek organizmat
- Tema 7** Sjellja riprodhuese. Roli dhe funksioni i sjelljeve riprodhuese. Sjelljet kërkuese për partnerin seksual
- Tema 8** Strategjia konkurruese e meshkujve strategjia perzgjedhese e femrave.
- Tema 9** Ritualet martesore. Sjellja prinderore.
- Tema 10** Inteligjenca dhe përdorimi i mjeteve të punës
- Tema 11** Përdorimi i mjeteve të punës tek kafshët. Të kuptuarit dhe të menduarit tek kafshët
- Tema 12** Mekanizmat e vendimmarrjes tek kafshët
- Tema 13** Çështje të organizmit dhe sjelljes së primatëve. Evolucioni i primatëve. Strategjitë e evolucionit të jetës tek primatët
- Tema 14** Prezantim i detyrave të kursit
- Tema 15** Prezantim i detyrave të kursit

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	30%
Vlerësimi vjetor: Seminare	10%
Kontrolli final	60%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Vlerësimi	-40	41-50	51-60	61-70	71-80	81-90	91-100

FREKUENTIMI:

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesëshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

FORMATI I LËNDËS:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e një provimi të pjesëshëm, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa ndonjë arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

KOMUNIKIMI:

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë ose në adresën zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës në internet: www.univlora.edu.al apo në adresën elektronike të pedagogut ina.nasto@univlora.edu.al.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

KODI I NDERSHMËRISË:

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrat që u jepen. Nuk lejohen kopjimet nga njeri-tjetri në provime, për detyrat e kursit, të shtëpisë, etj. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtimin e studentit nga universiteti

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

M Qirjo. , 2004: Etologjia. FSHN, UT. Tiranë

b) Literatura e rekomanduar:

Icock J.: Etologia. Un approccio evolutivo. Zanichelli
Haupt - Il Comportamento degli animali domestici – ed italiana a cura di Marina Verga EMSI Roma
Martin P., Bateson P., (2009). La misurazione del comportamento. Una guida introduttiva.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë.

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrave. Nuk lejohen kopjimet nga njëri-tjetri në provime, për detyrat e kursit, të shtëpisë, etj. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtim nga universiteti.

Nuk lejohet përdorimi i telefonave celulare dhe pirja e duhanit në auditor.

PEDAGOGU I LËNDËS

PhD. Ina Nasto

.....